

## "Kur shkolla hap dritare për botën..."

*Drejtori i shkollës, Stergios Papadopoulos*

***Si do t'i përgjigjemi pyetjes së fëmijëve: "Çfarë do të thotë ndryshim?"***

Çdo ditë, si arsimtarë mes fëmijëve, duhet t'u japim përgjigje pyetjeve të kësaj natyre. Asnjë teori pedagogjike dhe asnjë ligj arsimor nuk ekziston, që të na orientojë për t'u dhënë përgjigje të qartë e të pastër këtyre pyetjeve. Ndryshimin, të cilin nuk mund ta përkufizojmë me fjalë, e materializojmë me veprimet tona të përditshme dhe e përcaktojmë. E përcaktojmë me punën tonë arsimore, me mënyrën dhe arsyet për të cilat me disa njerëz brenda dhe jashtë shkollës kemi lidhje, ndërsa me disa te tjerë jo. Me mënyrën si komunikojmë me të tjerët dhe me cakun që përcaktojmë në shkëmbimet tona të përditshme.

Arsimtari nuk mund ta ketë të qetë ndërgjegjen e tij vetëm e vetëm se u ofron shanse të barabarta nxënësve të tij. Sepse nuk mjafton vetëm t'u ofrojmë fëmijëve shanse të barabarta, por, më së pari, duhet t'i nxisim ata dhe t'i garantojmë që t'i gëzojnë realisht. Dhe që të kemi rezultate në nxitjen e tyre, duhet të kemi parasysh veçoritë e çdo fëmije të veçantë, të cilat identifikohen me fantazinë, me krijimin dhe prirjet e veçanta, që gjithsecili nga ne ka në vetvete. Këto elemente kur njihen brenda komunitetit shkollor, i sigurojnë fëmijës një rol të veçantë pozitiv, të cilën mësuesi detyrohet ta kultivojë më tej. Në këtë mënyrë u japim fëmijëve edukatën dhe arsimin e nevojshëm në mënyrë që t'i shfrytëzojnë shanset që u ofron shkolla. Domethënë u sigurojmë atyre themelin e nevojshëm për shanse të barabarta, duke respektuar në radhë të parë personalitetin e çdo fëmije dhe jo duke barasniveluar nxënësit tanë në altarin e kërkesave të të nxënësve dhe të kërkesave tona, para të cilëve - në një mënyrë ose në një tjetër - çdo nxënës reagon me ritme të ndryshme.

Duhet t'i ndihmojmë fëmijët që të nxjerrin në pah elementet më pozitive të karakterit të tyre të veçantë, të kuptimit të nocionit "ne", të respektit të ndërsjellë, të bashkëpunimit dhe të komunikimit krijues. Duhet të nxisim dhe të inkurajojmë të gjithë nxënësit duke nxjerrë në dritë veçoritë e tyre të papërsëritshme si dhe nevojat e tyre të veçanta, rezistencat e tyre si dhe përplasjet e ardhme brenda grupit. Dhe, pa dyshim, një gjë e tillë nuk është e lehtë për t'i dalë mbanë gjithmonë. . .

Shkolla u takon të gjithëve. Është shtëpia e paqes. Është shtëpia e shpirtrave feminare. Është shtëpia e parë e takimit të njerëzve. Larg dhe mbi vetitë e qytetarit kombëtar, të qytetarit evropian ose të qytetarit të botës, duhet të ndihmojmë në kultivimin e vetive të tilla të qytetërimit - që ai të bëhet përçues i një kulture personale. Të kulturës së një njeriu, i zi, i bardhë, ose kinez etj. shikon elemente e përbashkëta, shikon larg dhe mbi përkufizimet dhe ka ndjesi të ekzistencës së tij si brenda vetvetes ashtu dhe për botën përreth. Nëse duam një gjë të tillë atëherë ndryshimi nis në radhë të parë nga secili prej nesh, madje përmes rolit të veçantë që secili prej nesh luan në shoqërinë civile.

***Gjatë gjithë këtyre viteve jemi përpjekur përmes veprimtarive (ndërkulturore - shumëkulturore) të shkollës sonë të përfitojnë të gjithë fëmijët, pa asnjë dallim. Për një shkollë të hapur para shoqërisë, një shkollë që kultivon ndjenjën e lirisë, vetëveprimit, vetadministrimit dhe pjesëmarrjes.***